



INSTITUCIONET E PERKOHSHME VETE QEVERISESE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVES – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT
SHKENCES DHE TEKNOLOGJISE

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU

UDHËZIMI ADMINISTRATIV

LËNDA: LEJIMI DHE REGJISTRIMI I INSTITUCIONEVE ARSIMORE PRIVATE

NUMER: 9/2002

DATË: 08.10.2002.

Në përputhje me ligjin mbi arsimin fillor dhe të mesëm, Rregullores 2001/19 Mbi Degen e egzekutivit të Institucioneve Vetqeverisëse në Kosovë të datës xx.xx.2001, Ministria Shkences dhe Teknologjis (këtu e tutje: MASHT) Lëshon Udhëzim administrative vijues:

Neni 1

Qëllimi

Institucionet arsimore private kanë kapacitet për të arsimuar numer domethanës të banorve të Kosovës. Institucionet e tilla zgjerojnë fushat e arsimit të disponueshme për banoret Kosovare dhe rezultojnë në kursimin financiar të Ministris së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.

Neni 2

Fushveprimi

Institucionet arsimore private të cilat ofrojnë mundësit e arimit legjitim janë në interes të popullit të Kosovës. MASHT-i mund të siguroi ndihmë dhe mbrojtje për personat të cilët zgjedhin institucionet arsimore private duke krijuar fushë-veprim dhe proceduren për të siguruar vertëtsin dhe ligjshmerinë e institucioneve të tilla.

Neni 3

Lejimi

3.1. Institucionet arsimore private në cilin do nivel të arsimit fillor dhe të mesëm që veprojnë në Kosovë duhet të kërkojnë leje nga MASHT-i.

3.2.Nji institucion arsimor ptivat mund të filloj veprimin vetëm pasi të ketë marrë leje prej MASHT-it, por mund të shpall konkurs dhe të rekrutojë nxënës varsisht nga leja që i është dhënë institucionit.

Neni 4 Regjistrimi

4.1.MASHT-i do të regjistrojë të gjitha institucionet arsimore private të cilat kanë siguruar lejen.

4.2.Pas vitit të pare të regjistrimit, institucionet arsimore private do të regjistrohen çdo vit në MASHT.me qëllim të përmbushjes së kriterëve për regjistrim,institucioni arsimor privat duhet të vazhdoj të plotësojë kriteret për miratimin e lejes dhe të sigurojënjë rishikim të punës së planittë punës dhe një garancion vjetor siq është parapar në nenin 6.2.3.më poshtë.

4.3 MASHT-i do të mbajë listen e institucioneve arsimore private tëregjistruara dhe listen e tillë do t'ia bëjë të mundshme publikut.

Neni 5 Informimi

5.1.Në bazë për lejim dhe regjistrim, institucioni arsimor privat do të sigurojë informata për MASHT-in meqë MASHT-i ka nevojë të përcaktojë natyren dhe veprimtaritë e arsimit shkollor, duke përfshirë por jo përkufizuar me këto më poshtë:

- a) kërkesa për pranim dhe regjistrim;
- b) ngarkesa me takes dhe vijë- veprimi i riderdhjeve të një shume parash;
- c) plan-programi;
- d) shpallja institucionale;
- e) të gjitha kontratat e rëndësishme/marveshjet;
- f) financimi dhe shenimet financiare;
- g) shenimet e pronsis;
- h) çertifikimi institucional dhe shenimet funksionale;
- i) shenimet përsonale;
- j) shenimet e veprimeve diciplinoretë imponuara nga institucioni,ose kunder institucionit ose kundër përsonelit ose nxënësve;
- k) dokumentet e shkolles dhe dosjet tëcilat përmbajën të dhënat që kanë të bëjnë me tituj akademik,nivelet,diplomat e dhëna dhe periudhat e vijimit;
- l) dhe çeshtjet tjera që do të vendos MASHT-i.

5.2.MASHT-i do të ketë autorizim për të vertetur saktësinë e informatës së pranuar, duke kontrolluar ose ndonji veprim tjetër për të cilin vlersohet se është i nevojshëm.

Neni 6 Zbulimi I të dhënave financiare

6.1.MASHT-ido ti mbaj të mbyllura të dhënat financiare të ofruara nga institucioni arsimor privat dhe nuk do ti përdor për qëllime tjera përveq në raste të një hulumtimi qeveritar civil ose hulumtimi kriminal i cili bëhet me dije MASHT-it.

6.2.Zbulimi i pa autorizuar i shënimeve financiare nga MASHT-i mund të rezultojë me veprim disiplinor kundër personit përgjegjës për zbulim të autorizuar.

Neni 7.

Kriteret/Kushtet për licencimin e IAP

7.1.Asnjë IAP nuk do të funksionojë si shkollë private në Kosovë pa miratim nga MASHT-i.

7.2.Kriteret për dhënjen e lejes formohen nga MASHT-i dhe do të përbëjnë lejen me standard qeveritar duke përfshirë nenet që kanë të bëjnë me:

I-Kushtet themelore

1.Kushtet e përgjithshme:

- a. Kërkesa për licencim të IAP,
- b. Vendimin për themelimin e IAP
- c. Struktura organizative e IAP,
- d. Arsytimi për fillimin e veprimtarisë së IAP,
- e. Historiku i shkurtër i IAP (për ato që kanë funksionuar më pare)

2.Objekti shkollor:

- a. Mjaftueshmëria e ndërtesave dhe paisjeve,
- b. Vendi dhe adresa e plotë e IAP,

3.Kushtet ligjore:

- a. Çertifikata e regjistrimit nga organi kompetent,
- b. Pronësia e lokaleve dhe / ose gjatësia e kohës së marrjes me qira të lokaleve,
- c. Vërtetimi mbi plotësimin e kushteve sanitare të objektit të IAP,

4.Kushtet kadrovike:

- a. Lista e kuadrit arsimor,udhëheqës ,administrative dhe ndihmës, kualifikimet e tyre (fotok. E Diplomave / Çertif.)
- b. Programet lëndore (kurrikulet) sipas klasëve,drejttimeve,
- c. Lista e teksteve dhe mjeteve mësimore që do të përdoren,
- d. Plani dhe programi vjetor i punës së IAP,
- e. Emërtimi i dokumentit që IAP do ti lëshoj nxënësit,
- f. Teksti i kontratës mes IAP dhe mësimdhënësit.

5.Nxënësit:

- a. numri i planifikuar i nxënësve për regjistrim,
- b.teksti i kontratës mes IAP dhe nxënësit/prindit të nxënësit.

6.Kushtet financiare:

- a. Garancioni për mbrojtje financiare të IAP në forca të veta për së

paku tri vjet.Një garancion i mëtejme i till do ti dorëzohet MASHT-i për regjistrim për çdo vit.

- b. Shuma e caktuar për pagesë për kokë nxënësi për çdo vit shkollorë,sipas destinimit.

II-Kushtet plotësuese:

- a. Statuti për qeverisje dhe rregullorja për rendin shtëpiak;
- b. Kodi i mirësjelljes i IAP.

7.3.Secilit IAP i cili i plotëson kriteret do ti jepet leja.

7.4.Do të jetë një mundësi për dëgjim brenda Masht-it nëse miratimi nuk është bërë; në mbështetje të dëgjimit, do të mirret vendim administrative përfundimtar i MASHT-it varësisht nga rishqyrtimi sipas mendimit të Komisionit dëgjues.

Neni 8.

Mbyllja e IAP

8.1.Një IAP mund të mbyllet nga pronari (pronarët) vetëm në fund të vitit shkollor.

Ndëshkimi mund të imponohet në cilindo institucion i cili mbyllet gjatë vitit shkollor.

8.2. Leja për një IAP do të përfshij kushtin për një obligim të huamarrjes për të mbrojtur interesat financiare të nxënësve të cilët kanë nevojë për të kryer shkollimin e tyre në ndonjë institucion tjetër në rast të mbylljes.

Neni 9.

Mbajtja e dokumentacionit

9.1.Të gjitha IAP duhet të mbajnë dosjet e përhershme të të gjithë nxënësve të regjistruar aty në çfardo kohe.

9.2.MASHT-i mund të kërkoj që IAP të sigurojnë një plan të pranueshëm për MASHT-i për të ruajtur të gjitha dosjet e tilla për së paku 10 vjet.

9.3.MASHT-i mund të kërkoj që plani i tillë të përfshij arkivimin e vazhdueshëm të dorëzansisë me qëllim të ruajtjes së dosjeve pasi që asoshkollë e tillë të ketë pushuar së ekzistuari.

Neni 10.

Mashtrimi dhe keqpërfaqësimi

10.1.MASHT-i nuk do të siguroj leje ose regjistrimi për IAP nëse ka pasur kallëzim administrative për mashtrim ose keqpërfaqësim,ose kallëzim penal,civil ndaj shkollës ose pronarëve të saj,zyrtarëve,ndërmjetësve apo organizatës sponzorizuese.Kallëzimi i tillë për mashtrim ose keqpërfaqësim do të jetë shkak i mjaftueshëm për zyrën (MASHT) që ajo të vendos që shkolla nuk është e autorizuar të funksionojë.

Neni 11.

Taksa administrative

11.1.MASHT-i mund të mbledh një shumë të arsyeshme të taksave të lejitimit dhe regjistrimit,në një lartësi që do të krijoj mbulesë të mjaftueshme por nuk tejkalon shpenzimet e administrimit të programit të lejitimit dhe të regjistrimit.

Neni 12.

Kontrollimi i shkollës

12.1.MASHT-i mund të vizitoj IAP në çfardo kohe pa paralajmrim me qëllim të kontrollimit të shkollës.

12.2.Stafi i shkollës ka për detyrë të bashkëpunoj me MASHT-in në kryrjen e kontrollit.

Neni 13.

Parashtesa e ankesës

13.1.MASHT-i mund të përcjellë parashtresën e ankesës në IAP. Shkolla ka të drejtën të përgjigjet në parashtresën e ankesës.

13.2.Parashtresa e ankesës mund të specifikojë veprimin i cili duhet të mirret për të përmbushur ankesën. Nëse veprimi nuk bëhet brenda kohës së arsyeshme ashtu siç kërkohet nga parashtresa.Masa e fundit duhet të jetë heqja e shkollës nga regjistri.

Neni 14.

Ndryshimi

14.1.IAP mund të bëj kërkesë në MASHT nëçfardo kohe për ndryshim të kushteve të lejës.

Neni 15.

Hyrja në fuqi

15.1.Hyrja në fuqi e këtij Udhëzimi Administrativ qetë jashtë fuqie juridike.

Udhëzimin Administrativ të më parshëm “Lejimi dhe Regjistrimi i IAP” ,numër 30/2001 , date 14 shtator 2001.

15.2.Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi më xx. Xx. Xxxx.

Mr.Rexhep Osmani Ministër,
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë